




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA) PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë:

- Konsideron thelbësore respektimin e parimeve themelore gjatë zhvillimit të veprimtarisë audiovizuale në drejtim të garantimit të lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe së drejtës për informim, si të drejta që burojnë nga Kushtetuta dhe legjislacioni i posaçëm.

- Mban në vëmendje sfidat që ka tregu audioviziv për zhvillimin e shërbimeve audiovizive të tyre në pavarësi të plotë dhe efikasitet cilësorë editoriale, duke respektuar vlerat dhe integritetin e shoqërisë shqiptare, në zbatim të ligjit dhe kërkesave për teknologji të reja, sipas standardeve ndërkombëtare.

- Beson se Autoriteti Rregullator i Mediave, në rolin e tij si nxitës i tregut audioviziv, në ushtrimin e funksioneve të tij rregullatore dhe mbikëqyrëse të veprimtarive audio dhe audiovizive, duhet të garantojë efikasitetin e zbatueshmërisë së ligjit dhe përgjegjshmërinë e duhur për kalimin me sukses të transmetimeve analoge në ato numerike, si dhe monitorimin e përmbajtjeve dhe mbikëqyrjen e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave.

- Mban në konsideratë vlerësimet e ndryshme dhe rekomandimet e organizmave dhe institucioneve ndërkombëtare lidhur me lirinë dhe zhvillimin e medias në Shqipëri, si dhe shprehet i gatshëm për të kontribuar në përmbushjen e këtyre rekomandimeve, duke bashkëpunuar dhe mbështetur institucionet në vend.

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- AMA gjatë vitit 2017 ka ushtruar aktivitete dhe ka ndërmarrë vendime në përmbushje të objektivave ligjorë, bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe procesit të digjitalizimit, duke pasur në fokus edhe zbatimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit.

- Autoriteti është zhvilluar në aspekt të qeverisjes; numri i mbledhjeve të zhvilluara në vitin 2017 ka qenë 14 me pjesëmarrjen e çdo anëtari prezent në to.

- Ka miratuar një kuadër nënligjor shumë të rëndësishëm të tillë, si strategjinë institucionale të AMA-s dhe planin e veprimit institucional 2017-2019, i cili shërben si një udhërrëfyes për orientimin dhe prioritetet e AMA-s në vijim.

- Ka miratuar 7 akte, të cilat kanë fokus zgjidhjen e aspekteve lidhur me procedurat lehtësuese për subjektet për kalimin në transmetime numerike, si dhe rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive.

- Ka rishikuar Kodin e Transmetimit, duke e përditësuar me çështjet e referuara nga ankesat e qytetarëve dhe të reflektuara nga Këshilli i Ankesave.

- Ka vijuar me veprimtarinë e licencimit, autorizimit, rinovimit, konstatimit të pavlefshmërisë dhe heqjen e licencave.

- Ka lidhur kontratën e shërbimit me RTSH-në dhe ka monitoruar zbatimin e saj.

- Ka përmirësuar punën e tij përmes aktiviteteve të Këshillit të Ankesave, i dedikuar për zgjidhje të shqetësimeve qytetare në drejtim të sjelljes së OSHMA-ve, sidomos në aspekt të respektimit të Kodit të Transmetimit dhe sjelljes etike.

- Ka angazhuar Studion e Monitorimit në funksion të Bordit të Monitorimit të Medias për të monitoruar fushatën zgjedhore në mediat publike dhe private të transmetimit.

- Në drejtim të angazhimit të Autoritetit në përmbylljen e procesit të digjitalizimit dhe finalizimin e këtij procesi, AMA ka ndërmarrë aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2017, duke mbyllur transmetimin analog në qarqet Berat, Korçë dhe Fier; ndërkohë vijon procesi në qarqe të tjera në të gjithë Shqipërinë.

- Kuvendi përshëndet nxjerrjen e buletineve 6-mujore me të dhëna financiare për kompanitë mediatike, aksionet në tregun mediatik dhe fitimet e kompanive mediatike, si një përmirësim i dukshëm i punës së AMA-s, që ka të bëjë me transparencën dhe llogaridhënien e aktivitetit të OSHMA-ve.

- Ka ndjekur procesin e lirim të brezit të Digjital Dividentit 1 dhe ka monitoruar përdorimin e spektrit nga audio të palicencuara, duke ndaluar transmetimet në to.

- AMA ka intensifikuar inspektimet në terren, duke kryer 458 të tilla (dyfishin e vitit 2016), në përfundim të të cilave ka vendosur 64 gjoba dhe 24 sekuestrime.

- Është rritur arkëtueshmëria e gjobave për vitin 2017 dhe së bashku me shlyerjen e detyrimeve të mbartura të viteve të mëparshme, si dhe të vitit 2017 nga OSHMA, ka siguruar një bilanc pozitiv të të ardhurave.

- Gjatë vitit 2017 AMA ka regjistruar jo vetëm transmetimet analoge, por edhe ato digjitale, ka monitoruar reklamat në subjektet audiovizive kombëtare, ka kryer monitorime të edicioneve informative në subjektet audio dhe audiovizive kombëtare.

- AMA ka vijuar me zhvillimin e transparencës të veprimtarisë së saj, si dhe komunikimit dhe bashkëpunimit të pandërprerë me të gjitha subjektet e përfshira në fushën e medias dhe të të drejtave të transmetimit/autorit. Përditësimi i faqes zyrtare, spotet dhe fushatat informuese, buletinet dhe revistat periodike, botimet në fushën e medias, si dhe aktivitete të shumta gjatë vitit me objekt çështjet e ndryshme të medias, janë veprimtari që rrisin imazhin institucional dhe besimin për funksionim efektiv të AMA-s në interes të publikut të gjerë.

Kuvendi nxit dhe kërkon nga AMA për vitin 2018:

1. Miratimin e rregulloreve të ndryshme, sipas planit strategjik të veprimit, me qëllim plotësimin e kuadrit nënligjor dhe përmirësimin e zbatueshmërisë së ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;

2. Vijimin e shqyrtimeve tematike mbi përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të, duke garantuar respektimin e ligjit dhe Kodit të Transmetimit për reklamën dhe komunikimet tregtare, respektimin e standardit të shqipes së folur dhe të shkruar, si dhe mbrojtjen e fëmijëve në transmetimet audiovizive;

3. Vijimin e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit me RTSH-në, sipas kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;

4. Përfundimin e procesit të digjitalizimit në allotmenin Tiranë-Durrës, si dhe në dy allotmenë të tjerë brenda vitit 2018, duke bërë të mundur realizimin e procesit të digjitalizimit në nivel 80 për qind të popullsisë;

5. Garantimin e vijimësisë së transmetimeve audiovizive gjatë dhe pas periudhës tranzitore të kalimit në transmetime digjitale;

6. Vijimin në monitorimin e mbulimit të territorit dhe të cilësisë së sinjaleve të RTSH-së dhe operatorëve kombëtarë të licencuar për transmetimet numerike, si dhe monitorimin e transmetimeve analoge të RTSH-së deri në mbylljen e tyre;

7. Përmirësimin e mbikëqyrjes në identifikimin e interferencave që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre;

8. Vijimin e monitorimit dhe forcimit të luftës kundër fenomenit të piraterisë, duke shtuar koordinimin me AKEP-in dhe institucione të tjera ligjzbatuese kundër luftës së formave të reja të piraterisë nëpërmjet internetit;

9. Vijimin e ndjekjes së realizimit të detyrimeve financiare të subjekteve debitoare të licencuara/autorizuara të vitit 2018 dhe atyre të viteve 2015-2017, si dhe të subjekteve që u është hequr licenca/autorizimi apo u është bërë e pavlefshme, me qëllim arkëtueshmërinë e të ardhurave të pritshme të institucionit, duke realizuar shpenzimet dhe investimet për vitin 2018, në përputhje me objektivat e institucionit;

10. Rritjen e efikasitetit në shqyrtimin e ankesave të ardhura nga qytetarët dhe institucionet për shkelje të parimeve të mbrojtjes së interesit publik, respektimit të dinjitetit të individëve dhe rregullave që parashikohen në Kodin e Transmetimit, si dhe shtimin e organizimit të tryezave tematike, si dhe dëgjësive me grupe të ndryshme interesi për njohjen me përmbajtjen e Kodit të Transmetimit dhe ndërgjegjësimin e respektimit të tij;

11. AMA të forcojë më tej pavarësinë e tij si rregullator i tregut mediatik dhe të funksioneve mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse në drejtëm të sigurimit të diversitetit dhe pluralizmit, transparencës së reklamave shtetërore, si dhe të bëhet promotor i zbatimit më të mirë të legjislacionit që garanton lirinë e shprehjes dhe të drejtës për informim, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë, si kërkesa të Komisionit Europian.

Miratuar në datën 7.6.2018